



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 46 datë 27.7.2021

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 63, DATË 28.12.2020 “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2021 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM
PËRFUNDIMTAR 2021 - 2023 TË BASHKISË SË SHKODRËS”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 27.7.2021, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 40 pika 4, nenin 54 shkronja “dh”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, të ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, neni 45 i ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, Udhëzimin plotësues nr.4 datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, VKB nr. 63, datë 28.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesem përfundimtar 2021 - 2023 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar dhe sipas relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rishpërndarjes të fondeve nga programi 04520, Rrjeti Rrugor Rural zëri “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, tek programi 08130 “Sport dhe Argetim” në zërin “Transferta korente te brendshme” si më poshtë:

Pakësime:

në 000/Lekë

Nr.	Nr Programi	Programi	Emërtimi I Programit	Artikulli 231 Shpenzime kapitale të trupëzuara	Institucioni
1.	04520 (Kap. 1)	Rrjeti Rrugor Rural	P04520.O3.A87 "Rikonstruksion Rrugë (Investime të pa detajuara)" Këto fonde të përdoren për investime të planifikuara në projekte sipas PBA 2021-2023	19,951	Bashkia Shkoder
2.	04520 (Kap. 5)	Rrjeti Rrugor Rural	P04520.O3.A87 "Rikonstruksion Rrugë (Investime të pa detajuara)" Këto fonde të përdoren për investime të planifikuara në projekte sipas PBA 2021-2023	10,049	Bashkia Shkoder
			Totali	30,000	

Shtesë:

në 000/Lekë

Nr.	Nr Programi	Programi	Emërtimi I Programit	Artikulli 604 Transferta korrente te brendshme	Institucioni
1.	08130 (Kap. 1)	Sport dhe Argetim	P08130.O2.A3. Administrimi i Klubit te futbollit Vllaznia (Shtesë)	19,951	Bashkia Shkoder

1.	08130 (Kap. 5)	Sport dhe Argetim	P08130.O2.A3. Administrimi i Klubit te futbollit Vllaznia (Shtesë)	10,049	Bashkia Shkoder
			Totali	30,000	

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 27 vota

Vota Pro 27

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 28.7.2021